



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1150/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, panelist individual Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “MOBELLAND” Sh.p.k - Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “TRENDY HOME” SH.P.K – Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar për objektin e emergjencës në QKMF Deçan” me nr. të prokurimit: 631-20-7703-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Deçanit, më datë: 15.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “MOBELLAND” Sh.p.k - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për objektin e emergjencës në QKMF Deçan” me nr. të prokurimit 631-20-7703-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Deçanit.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar për objektin e emergjencës në QKMF Deçan” me nr. të prokurimit: 631-20-7703-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Deçanit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “MOBELLAND” Sh.p.k - Suharekë, refuzohet si e pa bazuar të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "MOBELLAND" Sh.p.k - Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.12.2020 me nr. 1150/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për objektin e emergjencës në QKMF Deçan" me nr. të prokurimit: 631-20-7703-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Deçanit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 12.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin. 1

Lidhur me pretendimin ankimor ku njeherit thuhet se Autoriteti Kontraktues ka eliminuar Operatorin Ekonomik ankues në mënyrë të pa drejtë pasi që ka ofruar çmimin jo normalisht të ulët, Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik duke u bazuar në dokumentet e poseduara dhe në Ligjin për Prokurim Publik, konsideron se pretendimi ankimor është jo i drejtë pasi që përkitazi me LPP-në Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Harmoni me dispozitat ligjore, edhe pse Operatori Ekonomik Ankues pas kërkesës për sqarim nga Autoriteti Kontraktues ka kë bashkangjitur listën në mënyrë tabelore, mirëpo këto çmime nuk përputhen me çmime të tregut dhe nuk ofrojnë cilësinë e produkteve ashtu siç potencon Operatori Ekonomik Ankues, sepse nje çmim i tillë abnormalisht i ulët nuk mund të përmbushë kërkesat e Dosjes së Tenderit. Prandaj vijmë në përfundim që ky pretendim i Operatorit Ekonomik Ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin. 2

Duke u bazuar në pretendimin tjetër ankimor ku Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik në bazë të pikave të cekura ankimore, fillimisht shpjegon se Autoriteti Kontraktues Operatorin në fjalë e ka eliminuar edhe për mos posedim të dokumenteve të bashkangjitur në E-Prokurim konkretisht sigurimin e tenderit, e që nga Operatori Ekonomik thuhet duke u arsyetuar se për shkak të një gabimi teknik nuk është bashkangjitur kjo kërkesë, por pas kërkesës për sqarim nga AK për tenderët me çmim jo normalisht të ulët, Operatori Ekonomik ankues e ka bashkangjitur edhe këtë Dokument të cilin fillimisht nuk e ka poseduar e që

ka qenë edhe arsyeja e dytë e eliminimit ndaj këtij Operatorit Ekonomik. Ekspertja shqyrtuese profesionale konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik pasi që OE fillimisht ka rezultuar me çmim të ulët, pastaj është konstatuar se nuk e ka të bashkangjitur edhe Sigurimin e Tenderit ku thuhet se për shkak të gabimeve teknike nuk është ofruar. Mund ta kemi parasysh që Operatori Ekonomik Ankues gjatë Seancës Dëgjimore mund të vërtetojë apo tregojë me fakte apo arsye më të forta përkitazi me Ligjin ndaj Panelit Shqyrtues dhe Autoriteti Kontraktues lidhur me këtë pikë sepse një arsyetim i tillë nuk e kundërshton veprimin e Autoritetit Kontraktues, pasi që duhet pasur parasysh që fillimisht nuk ka qenë i bashkangjitur Sigurimi i tenderit dhe arsyetimi i Operatorit Ekonomik Ankues nuk e plotëson mangësinë e Dokumentit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit Publik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me hapat e më tutjeshëm.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 13.01.2021 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet plotësisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik nuk ka përgjigje

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, por nuk kanë qenë të pranishëm asnjëra palë, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “MOBELLAND” Sh.p.k – Suharekë, se autoriteti kontraktues ka eliminuar operatorin ekonomik ankues në mënyrë të pa drejtë pasi që ka ofruar çmimin jo normalisht të ulët, paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi ankimor është jo i drejtë pasi që autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me dispozitat ligjore, edhe pse operatori ekonomik ankues pas kërkesës për sqarim nga autoriteti kontraktues ka bashkangjitur listën në mënyrë tabelore, mirëpo këto çmime nuk përputhen me çmime të tregut dhe nuk ofrojnë cilësinë e produkteve ashtu siç potencon operatori ekonomik ankues sepse një çmim i tillë abnormalisht i ulët nuk mund të përmbushë kërkesat e dosjes së

tenderit.

Kurse, sa i përket pretendimit tjetër ankimor, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional duke u bazuar në pretendimin tjetër ankimor, fillimisht shpjegon se autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin në fjalë edhe për mos posedim të dokumenteve të bashkangjitur në E-Prokurim, konkretisht sigurimin e tenderit, e që nga operatori ekonomik thuhet duke u arsyetuar se për shkak të një gabimi teknik nuk është bashkangjitur kjo kërkesë, por pas kërkesës për sqarim nga AK për tenderët me çmim jo normalisht të ulët, operatori ekonomik ankues e ka bashkangjitur edhe këtë dokument të cilin fillimisht nuk e ka poseduar e që ka qenë edhe arsyeja e dytë e eliminimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional të prokurimit, vlerëson se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik pasi që OE fillimisht ka rezultuar me çmim jo normalisht të ulët, pastaj është konstatuar se nuk e ka të bashkangjitur edhe sigurimin e tenderit. Andaj, AK ka bërë vlerësim të drejt konform nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Kuvendi Komunal i Decanit";
- 1x1 OE "Mobelland Sh.p.k Suhareke";
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.